



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e “Fakultetit Teknik”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 1763/1 Prishtinë 25.05. 2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV

Studenti **Melita Matoshi** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Rezistenca siizmike e ramave betonarme** ” në programin e studimeve Master Konstruktiv dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakti

Dëmet e rënda të shfaqura nga ndërtesat me rama prej betoni (R/C) nën tërmete kanë vërtetuar shpesh cenueshmërinë e lartë të strukturave egzistuese ndaj veprimeve sizmike, kryesisht për shkak të një sjellje të pakënaqshme të nyjeve tra-shtyllë. Gjatë veprimit të ndonjë tërmeti të forte krijohen gjendje kaotike. Projektimi ndaj veprimeve sizmike çdo ditë po bëhet më i rëndësishëm dhe synon që të sigurojë: mbrojtjen e jetës njerzore, kufizimin e dëmtimeve në ndërtesa si dhe funksionimin e tyre në rast të ndonjë tërmeti. Shpesh ndodh që vlersimi sizmik i një ndërtese është më i vështirë se sa projektimi i një ndërtese të re. Vlerësimi i dëmit bazohet në disa parime dhe si qëllim kryesor ka numrin më të vogël të viktimave, ashtu si EC8. Gjatë fazes së ndërtimit struktura nuk duhet të pësojë asnjë ndryshim gjatë rasteve në jetëgjatësinë e saj, me përjashtim të rasteve kur sigurohen sipas ligjeve dhe verifikimeve të përshtatshme. Për shkak të natyrës specifike që ka reagimi sizmik në structure, vlerësimi sizmik i ndërtesave ekzistuese ka si vendimarrje kryesore për nevojën e rehabilitimit të çdo ndërtese individuale. Procedura e vlerësimit të detajuar është më e komplikuar duke u bazuar në projektin kryesor, projektin realizues, inspektimet në vend, inspektime të zgjeruara si dhe kuadri profesional.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.